

GJYKATA E QARKUT TË PEJËS

AP.nr.93/2010

Datë: 07 shtator 2010

NË EMËR TË POPULLIT

Kolegji prej tre gjyqtaresh në Gjykatën e Qarkut të Pejës i përberë nga gjyqtari i EULEX-it, Ingo RISCH, si kryetar i Trupit Gjykues, gjyqtari i EULEX-it Riku JAAKKOLA dhe gjyqtari vendor Salih MEKAJ, si anëtar të kolegjit gjykues,

Në rastin penal kundër,

ABEDIN MUZLIJAJ, i biri i Muharrem Muzlijaj dhe Ajshe Pecaj, lindur më 22.12.976 në fshatin Banjë e Pejës, Komuna e Istogut, me vendbanim në të njëjtin vend, me numër të letërnjoftimit 1003239256, i martuar, hetues në Stacionin Policor në Pejë, – ID nr. 1048, shqiptar i Kosovës.

I dënuar me një (1) vit dhe gjashtë (6) muaj burgim, i cili dënim pezullohet me kusht që i akuzuari të ti kompensoj demin e shkaktuar dhe , në shumën prej 4.500,00 euro dhe 700 franga zvicerane, përmes aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Klinës, P. Nr. 36/10 të datës 25 mars 2010,

Për veprën penale *Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit*, në kundërshtim me Nenin 339 par. 2 të KPK-së,

Duke vendosur në bazë të ankesës së Prokurorit Special, të parashtruar më 10 qershor 2010, të dy ankesat e avokateve mbrojtës të të pandehurit Orhan Basha dhe Ferid Gjickolli, të parashtruara më 14 qershor 2010 dhe përgjigjen në ankesë të Prokurorit Special, e parashtruar nga avokati Orhan Basha, më 18 qershor 2010,

në seancën e mbajtur më 7 shtator 2010, në praninë e të pandehurit Abedin Muzlijaj dhe avokateve të tij mbrojtës

Pas këshillimit dhe votimit, më 7 shtator 2010, shpall publikisht këtë

AKT GJYKIM

Ankesa e Prokurorit Special pjesërisht APROVOHET dhe aktgjykimi i Gjykatës Komunale të Klinës, P.nr. 36/10 të datës 25 mars 2010, NDRYSHOHET në lidhje me kualifikimin e veprës penale, ashtu që i pandehuri shpallet fajtor për veprën penale *Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit*, në kundërshtim me Nenin 339 par. 2 të KPK-së, dhe kështu dënohet me një (1) vit dhe gjashtë (6) muaj burgim.



Ankesa e Prokurorit Special që ka të bëjë me pjesën lirues për veprën penale për *Mashtrim* në kundërshtim me Nenin 261 par 1 të KPK-së REFUZOHET dhe aktgjykimi lidhur me këtë pjesë KONFIRMOHET.

Ankesat e avokateve mbrojtës Orhan Basha dhe Ferid Gjokolli REFUZOHEN si të pabazuara.

ARSYETIMI

1. Historia Procedurale

Me anë të aktvendimit mbi fillimin e hetimeve të Zyrës së Prokurorisë Speciale, PPS.nr.2/2010 të datës 15.01.2010, kanë filluar hetimet kundër Abedin Muzlijaj, zyrtar policor hetues i Njësisë Hetuese të Stacionit Policor Regjional të Pejës, për veprën penale *Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit*, në kundërshtim me Nenin 339 par. 3 të KPK-së në lidhje me Nenin 1 të KPK-së dhe për veprën penale *Marrje e Ryshfetit*, në kundërshtim me Nenin 343 par 1 të KPK-së.

Në po të njëjtën ditë, Prokurori Publik kishte lëshuar një urdhëresë për masa të fshehta në formë të vëzhgimit video-fotografik në vendet publike, dhe vëzhgimin e bisedave në vendet publike.


Përveç kësaj, në po të njëjtën ditë, Prokurori Publik kishte kërkuar nga Gjyqtari i Procedurës Preliminare të Gjykatës së Qarkut të Pejës, të lëshoj një urdhëresë për masa të fshehta për përgjimin e telekomunikimeve. Gjyqtari i Procedurës Preliminare ka lëshuar urdhëresën më 15.01.2010.

Më 19.01.2010, Prokurori Special ka parashtruar një kërkesë për paraburgim kundër të pandehurit. I pandehuri ishte arrestuar në të njëjtën ditë.

Më 20.01.2010, seanca për paraburgim është drejtuar para gjyqtarit të procedurës preliminare. Pas seancës, gjyqtari kishte caktuar paraburgimin për një afat kohor prej një muaj, përmes aktvendimit PPQ.nr.4/10.

Më 21.01.2010, avokatet mbrojtës të të pandehurit kanë parashtruar dy ankesa kundër aktvendimit mbi paraburgimin. Përgjigja ndaj ankesave të avokateve mbrojtës është paraqitur nga Prokurori po në të njëjtën ditë.

Më 22.01.2010, duke vendosur në bazë të ankesave, kolegji prej tre gjyqtaresh i Gjykatës së Qarkut të Pejës, përmes aktvendimit KP. Nr. 5/10, pjesërisht ka aprovuar ankesat dhe ka ndryshuar aktvendimin e gjyqtarit të procedurës preliminare. Kolegji prej tre gjyqtaresh vendosi që sjellja penale e të pandehurit duhet të cilësohet në shkelje të Nenit 339 par 2 të KPK-së, pasi që paratë e marra nga i pandehuri nuk e kalojnë shumën prej



5000 €. Kështu që rasti duhet ti referohet Gjykatës Komunale të Klinës, si kompetente lëndore, pasi që vepra penale bie në kuadër të Nenit 339, par. 2 të KPK-së, e cila parasheh dënimin deri në tre vite burgim, një shqyrtim gjyqësor plotësues duhet të mbahet.

Më 01.02.2010, Prokurori Special ka parashtruar një propozim akuzë kundër të pandehurit Abedin Muzlijaj, duke e akuzuar atë për veprën penale për *Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit*, në kundërshtim me Nenin 339 par. 2 të KPP-së në lidhje me Nenin 1 të KPK-së dhe për veprën penale për *Mashtrim*, në kundërshtim me Nenin 261 par. 1 të KPK-së

Shqyrtimi kryesor është mbajtur më 05.03.2010 dhe 25.03.2010.

Më 25.03.2010, gjykata e shkallës së parë, ka lëshuar aktgjykimin P.nr.36/10, me anë të së cilit i pandehuri lirohet nga vepra penale për *Mashtrim* në kundërshtim me Nenin 261 par. 1 të KPK-së, përderisa lidhur me veprën penale për *Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit*, në kundërshtim me Nenin 339 par. 2 të KPP-së në lidhje me Nenin 1 të KPK-së, i pandehuri shpallet fajtor dhe dënohet me një vit e gjashtë muaj burgim, dënim e cili do të pezullohet me kusht që i pandehuri ti kompensoj demin e shkaktuar palës së lënduar.

Sipas aktgjykimit të shkallës së parë, i pandehuri Abedin Muzlijaj është liruar nga kryerja e veprës penale për *Mashtrim* në kundërshtim me Nenin 261 par 1 të KPK-së. Lidhur me veprën penale për *Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit*, në kundërshtim me Nenin 339 par. 2 të KPP-së në lidhje me Nenin 1 të KPK-së, i pandehuri shpallet fajtor dhe dënohet me një vit e gjashtë muaj burgim, dënim e cili do të pezullohet me kusht që i pandehuri ti kompensoj demin e shkaktuar palës së lënduar.

2. Aktgjykimi i Shkalles së Parë P.nr.36/10

Gjykata e Shkallës së parë përderisa vlerëson provat ka përfunduar se deklaratat e dhëna nga të dy palët e dëmtuara/dëshmitarët dhe , në fazën hetuese, ku janë konfirmuar gjatë dëshmisë së tyre në shqyrtimin kryesor. Është konfirmuar se paratë që janë ofruar të pandehurit nga pala e dëmtuar/dëshmitarët, në shumën prej 4500€ dhe 700 franga zvicerane, ishte në mënyrë për të zbuluar kryesin e veprës penale për vrasjen e djalit të tyre, respektivisht vëllai, e cila ka ndodhur në vitin 2006, pasi që i pandehuri ishte përgjegjës për hetimin e rastit për vrasje si hetues policor i Policisë në Pejë.

Gjykata e shkallës së parë gjithashtu ka shqyrtuar pretendimet e të pandehurit se paratë ishin kërkuar si borxh. Por, ky borxh i pretenduar nuk ishte marrë si fakt, pasi që nuk kishte provë që vërtetonte faktin. Për më tepër, gjatë ekzaminimit të dëshmitarëve (të cilët qartë treguan se paratë janë ofruar në mënyrë për të zbuluar gjerat) ishte mundësia për të pandehurin dhe avokatet e tij mbrojtës që ti prezantojnë këtë rrethanë dhe të marrin në pyetje dëshmitarët lidhur me çështjen e huamarrjes. Por, asgjë nuk është prezantuar apo pyetur ndaj palës së dëmtuar/dëshmitarëve.



Përveç kësaj, nga një pjesë e shkëputur nga biseda e cila ishte vëzhguar në një vend publik ndërmjet palës së dëmtuar dhe të pandehurit më 17.01.2010, çështja e huamarrjes asnjëherë nuk është përmendur.

Prandaj, gjykata e shkallë së parë konsideron se i pandehuri ka shpërdoruar pozitën e tij zyrtare kur ka kërkuar dhe pranuar para nga pala e dëmtuar.

Lidhur me veprën penale të *Mashtrimit* (Neni 261 par 1 të KPK-së), gjykata ka konsideruar se vepra penale ishte kryer në ditën kur i pandehuri ka kërkuar paratë (10.000,00 €) dhe ka pranuar 3.000,00 €. Në muajt pasues, paratë të cilat janë ofruar në rastin e dytë dhe të tretë, ishte vetëm realizimi i premtimit i dhënë në ditën kur janë kërkuar paratë nga i pandehuri. Kështu që, mashtrimi nuk mund të njihet dhe i pandehuri ishte liruar nga kjo akuzë.

3. Ankesat

a) Ankesat e Prokurorit Special

Sipas ankesës së Prokurorit Publik, aktgjykimi i shkallës së parë ka shkelur Kodin e Procedurës Penale të Kosovës sa i përket sanksionimit penal.

Sipas opinionit të prokurorit, qëllimi i dënimit është të frenoj autorin e krimit për të kryer vepra penale në të ardhmen dhe të rehabilitoj aktorin e veprës, nuk mund të arrihet me anë të dënimit me kusht. Gjithashtu qëllimi është që të parandaloj të tjerët nga kryerja e veprave penale. Duke marrë parasysh se i pandehuri ishte njeri nga zyrtarët hetues përgjegjës për luftimin e krimit, dhe duke pasur parasysh se në Kosovë vepra penale e shpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit dhe korrupsioni janë shumë të pranishme, dhe se i pandehuri duhej të luftonte veprën penale për të cilën ai është shpallur fajtor, dënimi me kusht në këtë rast nuk do të arrij qëllimin e dënimit, për më shumë ai do të inkurajoj aktoret tjerë të krimit të kryejnë vepra të ngjashme penale.


Përveç kësaj, Prokurori Publik sjell prova se gjykata e shkallës së parë ka shkelur ligjin penal duke liruar të pandehurin lidhur me veprën penale të Mashtrimit. Sipas ankesës së gjykatës së shkallës së parë ka gabuar në përcaktimin se i pandehuri veç më ka parashtruar raport penal në Zyrën e Prokurorisë së Qarkut lidhur me rastin që ai ishte duke hetuar (rastin e vrasjes së _____), dhe për këtë rrethanë ai nuk ka informuar palën e dëmtuar dhe në vijim ka marrë 1500 Euro nga ata, duke përfituar në mënyrë jo ligjore për veten e tij. Pos kësaj, i pandehuri çorienton palën e dëmtuar lidhur me personat që kanë kryer vrasjen e cila është vërtetuar nga përmbajtja e bisedës së transkriptuar në mes _____ it (njeri nga pala e dëmtuar) dhe të pandehurit:

: Por ju nuk me treguat mua për të gjithë personat, ky është problemi?

Abedini: _____, nuk mund të ju tregoj juve pa qenë 100% i sigurt.

Prandaj, Prokurori Special i propozon Gjykatës së Qarkut të Pejës që të:

- shpall të pandehurin fajtor për veprën penale për mashtrim dhe të dënoj atë për këtë veprë penale, kështu që të ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dënoj të pandehurin me dënim burgimi të unifikuar



- Anuloj aktgjykimin e shkallës së parë lidhur me shfajësimin dhe të kthej rastin për rishqyrtim; ndërsa të ndryshoj aktgjykimin lidhur me dënimin me kusht, në këtë mënyrë të dënoj të pandehurin me burgim.

b) Ankesa e avokatit mbrojtës Orhan Basha

Ankesa e avokatit mbrojtës Orhan Basha sulmon aktgjykimin e shkallës së parë në baza të shkeljes substanciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljen e ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe të pjesshëm të gjendjes faktike dhe të vendimit mbi sanksionimin penal.

Sipas ankesës, pala e dëmtuar ka qenë e intervistuar nga policia dy ditë para se prokurori ka nxjerr aktvendimin mbi fillimin e hetimeve, dhe në ato deklaratë, emri i prokurorit i cili ka urdhëruar intervistën, koha dhe mënyra se si prokurori i ka besuar policisë që të drejtoj hetimet, mungon. Për me tepër, prokurori ka pyetur palën e dëmtuar, por nuk është përpjekur që të fton apo pyes të pandehurin fare, i cili është një obligim i prokurorit që ti ofroj mbrojtjes dhe të pandehurit me të gjitha dëshmitë të cilat janë të dobishme për mbrojtjen.

Pasi që i pandehuri në polici ka qëndruar i heshtur, prokurori fare nuk është përpjekur që të ftoj të pandehurin që të ofroj versionin e tij të fakteve dhe të ballafaqoj atë me palën e dëmtuar në mënyrë të sqarë se parat janë kërkuar dhe pranuar si huamarrje. Kjo rrethanë është shkelur po ashtu edhe gjatë shqyrtimit kryesor.

Si një shkelje e ligjit penal duhet të shqyrtohet gjithashtu pasi që aktgjykimi nuk përmban sqarimet në lidhje nëse vepra penale ishte në fakt vepër penale. Sipas ankesës, vepra penale e shpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit mund të manifestohet në dy mënyra:

Forma e parë –kur një person zyrtar ka për qëllim të përfitoj materialisht në mënyrë të paligjshme

Forma e dytë – kur një person zyrtar ka për qëllim të shkaktoj çfarëdo lloj dëmtimi.

Në të dy rastet veprimet në vijim janë të nevojshme: shpërdorimi i pozitës zyrtare, tejkalimi i kufijve të kompetencave dhe mos përmbushja e detyrave zyrtare.

Sipas ankesës, aktgjykimi i atakuar ka dështuar të ofroj përgjigjet lidhur me këto çështje. Aktgjykimi përshkruan se i pandehuri “ me qëllim të përfitimit të paligjshëm, ai ka shpërdoruar pozitën e tij zyrtare”; nëse ky do të ishte rasti, atëherë paragrafi 2 i Nenit 339 të KPK-së nuk mund të qëndroj, pasi që paragrafi 2 ishte i mundshme vetëm kur një person zyrtar shkakton dem dhe jo të përfitoj materialisht në mënyrë të paligjshme.

Në vazhdim, gjykata nuk ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur edhe me deklaratën e të pandehurit se paratë janë kërkuar dhe pranuar si borxh dhe e ka bazuar vendimin e saj në dëshmi të pambështetura.

Gjykata e shkallës së parë nuk përmend asgjë në lidhje me eprorin e të pandehurit se kur ata e kanë kërcënuar palën e dëmtuar se nëse ata nuk do të parashtronin kallëzim penal ndaj të pandehurit rasti i tyre do të mbetet i pazgjydhur dhe kështu rasti do të mbyllet. Pra, kjo rrethanë plotësuese ka mbetur e pazgjydhur nga gjykata e shkallës së parë.



Sipas ankesës, shkeljet e bëra nga gjykata e shkallës së parë kanë rezultuar në shpalljen e dënimit të gabuar. I pandehuri sapo ka qenë në gjendje financiarisht ti kthej borxhin që kishte marrë nga pala e dëmtuar , ai e ka bërë këtë, dhe konfirmimi i transaksionit bankar i është bashkangjitur ankesës.

Prandaj, avokati mbrojtës i propozon Gjykatës së Qarkut të Pejës, të ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Klinës dhe të liroj të pandehurin nga të gjitha akuzat pasi që nuk ka prova të mjaftueshme për ti mbështetur akuzat.

c) Ankesa e avokatit mbrojtës Ferid Gjikolli


Sipas ankesës së Ferid Gjikollit, gjykata e shkallës së parë ka lëshuar vendimin e saj bazuar vetëm në bazë të deklaratave të pjesëshme të palës së dëmtuar dhe ; vetëm nga pjesa e cila shkon në dëm të pandehurit. Në këtë drejtim gjykata nuk ka marrë parasysh pjesën e deklaratës ku pala e dëmtuar ka sqaruar se pas presionit që ata kishin nga eprori i të pandehurit, pala e dëmtuar kishte denoncuar të pandehurin.

Sipas ankesës gjykata ka gjetur deklaratat e palës së dëmtuar si të detyrueshme pa i ballafaquar me deklaratën e të pandehurit ku ai ka deklaruar se paratë janë kërkuar si borxh. Kështu që aktgjykimi nuk ka ofruar sqarimin e mjaftueshëm se pse gjykata nuk i ka besuar versionit të të pandehurit dhe për më tepër i ka munguar vlerësimi i provave në përgjithësi. Në këtë kuptim gjykata nuk ka marrë parasysh planin e amortizimit të huas të marrë nga banka, përfundimin e pagesës se borxhit të marrë dhe dëftesën me emrin dhe llogarinë bankare të . Veç kësaj, sipas ankesës, ishte e çuditshme se pse prokurori nuk i ka propozuar eprorit të pandehurit të ftohet si dëshmitar i cili veç me ka dhënë deklaratën e tij para prokurorit. Gjithashtu avokati vë në pyetje faktin se pse prokurori ka urdhëruar masat e fshehta kur pala e dëmtuar veç më kishte pranuar se i pandehuri kishte kërkuar para për të zbuluar vrasjen e anëtarit të familjes së tyre.

Ankesa gjithashtu shqyrton shkeljen e gjykatës lidhur me faktin se i pandehuri ka qëndruar në heshtje para policisë, dhe e ka marrë këtë si provë kundër tij. Dhe në vijim gjykata nuk i ka ofruar të pandehurit mundësinë që të pranon apo mos të pranon fajësinë. Prandaj është e çuditshme se përkundër shkeljeve të të drejtave të pandehurit, mbrojtja e tij merret në dëm të tij.

Kërkimi i parave si hua është një fakt i rëndësishëm për të cilën gjykata nuk është përpjekur që të verifikoj plotësisht. Në këtë drejtim gjykata duhej të ftohte në gjyq përsëri palen e dëmtuar dhe ti ballafaqoj ata me të pandehurin lidhur me këtë çështje shumë të rëndësishme. Gjithashtu edhe fakti i presionit të bërë nga eprori i të pandehurit ndaj palës së dëmtuar, gjykata duhet ti ftohte ata *ex-officio* me qëllim të sqaroheshin rrethanat e sipërpërmendura. Nga të përmendurat më lartë rrjedh se nga veprimet e të pandehurit nuk ka tipare të veprës penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit.

Në pjesën në vijim të ankesës, avokati Ferid Gjikolli vlerëson dispozitat e Nenit 399 të KPK-së, mënyrë të ngjashme sikur avokati Orhan Basha lidhur me përfitim të paligjshëm material dhe demin e shkaktuar.



Përfundimisht, avokati i propozon Gjykatës së Qarkut të Pejës që të aprovoj ankesën e tij, të anuloj aktgjykimin dhe të kthej rastin për rigjykim; apo ndryshe të ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dënoj të pandehurin me gjobë.

d) Përgjigja në ankesë të Prokurorit Special nga avokati Orhan Basha

Sipas përgjigjes ndaj ankesës nga mbrojtja, prokurori ka atakuar aktgjykimin lidhur me shkeljet e ligjit, veçanërisht lidhur me pjesën shfajësuese dhe ka dhënë sqarime të mëtutjeshme të cilat kolegji gjykues gjithashtu i ka marrë parasysh.

Prandaj, i propozon shkallës së dytë të refuzoj ankesën e prokurorit dhe të liroj të pandehurin.

4. Gjetjet e Gjykatës së Qarkut


Pas shikimit të aktgjyimit të shkallës së parë, ankesave dhe dokumenteve tjera të nevojshme të dosjes së rastit, konstaton se ankesa e Prokurorit Special do të aprovohet pjesërisht, përderisa ankesat e avokateve mbrojtës të parashtruara në emër të pandehurit do të refuzohen si të pabazuara.

a) Gjetjet faktike

Kolegji gjykues i apelit është i bindur se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar saktë gjetjet faktike pa shkelur rregullat procedurale pas verifikimit *ex-officio* nëse ka pasur shkelje të ndonjë dispozite ligjore të përmendura në Nenin 403 të KPPK-së. Për këtë arsye kolegji gjykues vendosi në seancën e saj më 07 shtator 2010 që të mos mbaj shqyrtim, shih Nenin 411(1) dhe (2) të KPPK-së, pasi që në përputhje me Nenin 412 (1) të KPPK-së- nuk ka nevojë për të marrë prova të reja në një rast anë e as nuk është e nevojshme për ti përsëritur provat të cilat veç më janë marrë, sepse një vërtetim i gabuar apo jo i plotë gjendje faktike mund të përjashtohet.

Prandaj vendimi i gjykatës së shkallës së dytë është i bazuar në faktet e njëjta të cilat veç më ishin vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, të cilat janë:

I pandehuri ishte hetues policor në Policinë e Pejës. Ai ishte përgjegjës për hetimin e rastit të vrasjes së (të birit të dhe vëllait). Në shkurt apo në mars 2008, i pandehuri ka shkuar në shtëpinë e , babait të të ndjerit, në Pogragjë dhe në praninë e ai ka kërkuar shumën e 10.000€, për të zbuluar autorin e vrasjes së , me justifikimin se ai duhej të paguante burimet e informacionit. Kështu që, ai e beri këtë edhe pse e dinte se ai mund të paguante informuesit nga buxheti i konsoliduar i Policisë së Kosovës. Në këtë mënyrë ai, ai ka pranuar shumën prej 4.500,00 eurove dhe 700 franga zvicerane nga dhe , në tre raste të ndryshme. Në rastin e parë, në ditën kur ai kishte kërkuar shumën 10.000,00 €, në shtëpinë e palës së dëmtuar ai ka pranuar 3.000€; në rastin e dytë tre javë më vonë ai ka pranuar 700 franga zvicerane në vendin e njëjtë dhe në rastin e tretë në




njërën nga ditët e qershorit 2008 ai ka pranuar 1500 €, gjatë bisedës që ai kishte pasur me palën e dëmtuar në restorantin “Astro” në fshatin Zllakuqan.

Këto fakte janë të bazuara në deklaratat e dhëna nga pala e dëmtuar dhe kolegji gjykues nuk ka as më të voglin dyshim se dëshmitarët dhe kanë dëshmuar të vërtetën kur ata janë intervistuar më datën 5 dhe më 25 mars 2010. Përmbajtja e dëshmimeve të tyre përputhet me gjetjet faktike të dyjave gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë. Gjykata është e bindur se dy dëshmitarët e sipërpërmendur kanë treguar të vërtetën, sepse nuk ka kundërtënie në deklaratat e tyre dhe ekziston një lidhje logjike fundamentale në deklaratat e tyre dhe gjithashtu kur këto dy deklarata të tyre krahasohen me njëra tjetrën. Gjithashtu nuk ka indikacione se njeri nga dëshmitarët mund të ketë ofruar dëshmi të rrejshme gabimisht, pasi që përshkrimi i të dyjave është i thjeshtë dhe i real. Kolegji gjithashtu ka përjashtuar se njeri nga këta dy dëshmitarë mund të ketë akuzuar të pandehurin gabimisht dhe padrejtësisht me qellim për të dëmtuar ata. Nuk ka asnjë indikacion se ndonjëherë ka pasuar marrëdhënie armiqësore apo jo shoqërore para kryerjes së krimit në mes të pandehurit dhe palës së dëmtuar. Përkundrazi të dy dëshmitarët kanë raportuar se marrëdhëniet e tyre me të pandehurin ishin harmonike. Gjithashtu hezitimi i tyre për të raportuar për transferim të parave kur janë marrë në pyetje nga zyrtaret e lartë policor tregojnë se ata nuk kishin për qellim të ofrojnë dëshmi të rrejshme në mënyrë për të akuzuar të pandehurin në mënyrë jo ligjore.

Në sajë të deklaratave të dëshmitarëve është e pakontestueshme të përjashtohet se i pandehuri ka kërkuar para si borxh. Të dy dëshmitarët kanë raportuar se i pandehuri e ka motivuar kërkesën e tij për para duke e arsyetuar se atij i nevojiteshin paratë në mënyrë për ti paguar informatorët. Kolegji gjykues është i bindur se i pandehuri duke qenë një polic i zgjuar e ka përdorur këtë legjendë në mënyrë që plani i tij të ketë sukses me qellim të përfitoj materialisht në mënyrë të paligjshme nga pala e dëmtuar. Duke mos zbuluar qëllimin e tij të vërtetë që të marrë dhe të mbajë paratë për veten e tij dhe duke pretenduar se i nevojiten për ti përdorur në interesin dhe për të mirën e palës së dëmtuar, i pandehuri e ka rrënjësuar apo të paktën e ka rritur gatishmërinë e palës së dëmtuar për ti paguar paratë atij. Dhe si një element i planit të tij, i pandehuri ka dashur që të paraqitet në sytë e palës së dëmtuar jo si një person i korruptuar por si një polic i cili është i përkushtuar që të mbështesë interesin e arsyeshëm dhe ligjor të palës së dëmtuar me qellim të marrjes së njohurive rreth vrasjes së të afërmit të tyre.

Bazuar në faktin se i pandehuri e ka mbështetur dëshirën e tij për marrjen e parave kinse në nevojën për ti paguar informatorët, pretendimi i të pandehurit në lidhje me marrjen e parave si hua nuk ka asnjë kuptim. Ky variant përben vetëm një përrallë të rëndomtë e sajuar nga i pandehuri në mënyrë të paraqitet në mënyrë me të mirë të mundshme.


Versioni i huamarrjes gjithashtu hidhet poshtë nga vëzhgimi i fshehtë i bisedës në mes të pandehurit dhe palës së dëmtuar. Në bazë të transkriptit të thirrjes telefonike, pala e dëmtuar e përkujton të pandehurin për të zbuluar rastin e të afërmit të tyre pasi që ta e kanë paguar të pandehurin për këtë qellim dhe ai vetë nuk e ka vënë në dyshim pranimin e parave nga ana e tij me qellim që ti paguajë informatorët e as nuk ka pohuar se “marrëveshja” ishte e natyrës së borxhit.



Përderisa mbrojtja është përpjekur të mbështes versionin e borxhit duke prezantuar fletëparaqitjen që përmbante emrin e dhe numrat e xhirollogarive bankare të Raiffesisen Bank dhe planin e amortizimit të Raiffeisen Bank, duhet të theksohet se këto dokumente nuk zënë vend për të kundërshtuar gjetjen faktike se i pandehuri ka kërkuar para nga pala e dëmtuar që ti paguaj atij shumën 10.000 Euro në mënyrë që ai të paguaj burimet e informacionit. Kolegji është i bindur se “dokumentet e huas” ishin nxjerrë pasi që i pandehuri ishte në dijeni se hetimet kishin filluar kundër tij. Kolegji gjithashtu ndan mendimin e gjykatës se shkalles së parë se një polic me përvojë si i pandehuri nuk do të kishte pritur që të paraqes versionin e borxhit deri në fund të shqyrtimit kryesor, por do ta paraqiste këtë çështje në një fazë më të hershme të procedurës, nëse kjo do të ishte një huamarrje. Edhe pse kjo është e tëra në dorën e të dyshuarit, që të ofroj dëshmi apo jo dhe në çfarë kohe ata të marrin vendimin e tyre. Po do të ishte në kundërshtim me të gjitha përvojat penale se një polic i cili ehte i akuzuar me pretendimin se ka përfutur materialisht në mënyrë të paligjshme dhe i cili është në prag që të intervistohet nuk e raporton huamarrjen në fazën më të hershme. Ky version i mbrojtjes mund vetëm të vlerësohet si një përpjekje e dështuar e të pandehurit për ti ikur përgjegjësisë së tij penale, edhe pse i pandehuri do të shkaktonte vepër penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare apo Autorizimit, Neni 339 KPK, nëse ai kishte kërkuar dhe pranuar para nga pala e dëmtuar lidhur me viktimën për të cilën ai si zyrtar policor ishte duke kryer hetimet. Kjo nuk ka nevojë të sqarohet me detaje të mëtutjeshme pasi që ekzistojnë të gjitha dyshimet e bazuara që përjashtojnë faktin se nuk është në pyetje huamarrja.

Lidhur me ankesën e mbrojtjes se eproret e të pandehurit, dy dëshmitarët dhe , nuk janë dëgjuar në shqyrtimin kryesor edhe pse të kenë qenë marrë në pyetje nga gjyqtari hetues, kolegji e ka marrë këtë në konsideratë. Fakti qëndron se asnjëra nga palët nuk ka kërkuar që njeri nga dëshmitarët të thirren në gjyq. Kështu kolegji gjykues mohon mundësinë që ti thërras ata në gjyq *ex officio*, sepse nga njëra anë nuk ka ndonjë mospërputhje qenësore në mes të deklaratave të dëshmitarëve dhe të dhënë në procedurën preliminare dhe deklaratave të palës së dëmtuar. Kurse në anën tjetër pretendimi i mbrojtjes se pala e dëmtuar ishin të *shtrënguar* ti japin përgjigje eprorit të pandehurit, është një keqkuptim i avokateve mbrojtës, sepse nuk ka asnjë indikacion që pala e dëmtuar të jetë ballafaquar me shtrëngim në mënyrë që të flasim me eprorin e të pandehurit. Vërtetimi i vetëm i saktë është fakti se palët e dëmtuara kishin ngurruar që të flasin rreth parave që atyre u ishin kërkuar nga i pandehuri dhe se ata i kishin ofruar atij paratë në mënyrë që të mbështeteshin zyrtarin policor në punën e tij zyrtare. Ishte në interesin vital të palës së dëmtuar që të marrin informacionin nga i pandehuri se kush e kishte vrarë të afërmin e tyre. Dhe kur ata ishin kontaktuar nga eproret e të pandehurit dhe ishin pyetur nëse në pyetje ishin paratë, pala e dëmtuar ishte ngurruese për të deklaruar sepse ata ende shpresonin në informacionin e dëshiruar nga i pandehuri dhe nuk dëshironin të rrezikonin synimin e tyre duke thënë të vërtetën. Hezitimi i tyre për tu përgjigjur është po aq qartë i pa shtrënguar sa edhe pozita insistuese e dhe për të marrë një përgjigje të kënaqshme lidhur me këtë çështje. Por është e pamundshme që ky insistim të quhet i forcuar.

Duke pasur të gjitha këto parasysh, huamarrja e pretenduar ehte aq larg me realitetin dhe duhet të përjashtohet pa dyshimin me të vogël me përfundimin se gjykata e shkalles së



parë kishte të drejtë për të mos urdhëruar marrjen e ndërsjellë në pyetje dhe gjithashtu kolegji gjykues ka përjashtuar përvojën për të dhënë një urdhëresë të tillë *ex officio*.

b) Konstatimet ligjore

a) Fillimisht duhet të vërtetohet se i pandehuri ka kryer një veprë penale *Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit*, në kundërshtim me Nenin 339 par. 1 në lidhje me par 2 të KPK-së.

I pandehuri ka shpërdoruar pozitën e tij zyrtare si një zyrtar policor duke kërkuar shumen prej 10.000 euro nga pala e dëmtuar duke e justifikuar kërkesën e tij me nevojën e pretenduar për ti paguar informatorët. Në të vërtetë ai ka pasur për qëllim që ti përdor paratë për qëllime të tij personale. Edhe pse i pandehuri ka pranuar para sipas planit të tij të paligjshme në tre këste, 3000 Euro menjëherë, pastaj 700 franga dhe më vonë 1.500 euro, ai ka kryer një veprë penale, sepse tre rastet e pranimit të parave fshihen pas planit dhe qëllimit të tij penal dhe duhen të konsiderohen se tre hapa të veprës së njëjtë penale.

b) Lidhur me klasifikimin ligjor, kolegji miraton konstatimin ligjor të gjykatës së shkallës së parë dhe është – në kundërshtim me opinionin e mbrojtjes- i bindur se rasti i rendë në kundërshtim me Nenin 399 par 2 të KPK-së është plotësuar, sepse të gjitha elementet nga Neni 339 par 1 dhe 2 të KPK-së janë plotësuar.


Siç është përshkruar më lartë, të gjitha elementet nga Neni 339 par 1 të KPK-së janë përmbushur. Neni 339 par. 2 të KPK-së i referohet paragrafit të tij 1. dhe kërkon elementin tjetër se vepra penale e përshkruar në par. 1 ka **rezultuar** në një dëm duke tejkalar shumen 2.500 euro. Me kërkesë të të pandehurit, pala e dëmtuar i ka paguar atij 4.500 plus 700 franga zvicerane të cilat ishin në shumë të pagesës prej 427 €¹, gjithsej në total 4.927 €. Dëmi i pakontestueshëm i palës së dëmtuar ishte 4.927 € në total, dhe ky dëm ishte **rezultati** i drejtpërdrejtë në Shpërdorim të Pozitës Zyrtare apo Autorizimit nga i pandehuri.

Kolegji gjykues nuk pajtohet me interpretimet ligjore të avokateve mbrojtës se par. 2 i Neni 339 të KPK-së nuk është përmbushur sepse nuk kishte qëllim që të shkactohej dëmi. Par. 2 i Neni 339 të KPK-së kërkon që elementet në vijim të plotësohen:

Kushtet nga Neni 339 par 1 të KPK-së duhet të plotësohen si parakushti i parë dhe si një parakusht në vijim që të plotësohet elementi që dëmi që tejkalon shumen 2.500€ si **rezultat** i kryerjes së veprës penale në kundërshtim me Nenin 339 par. 1 të KPK-së. Neni 339 par. 2 të KPK-së nuk kërkon qëllimin për të shkaktuar demin që tejkalon shumen 2.500 €, kushti nga dëmi që tejkalon 2.500€ duhet të jetë vetëm si rezultat i veprës penale të kryer në bazë të par 1. nga Neni 339 të KPK-së. Qëllimi i ligjbërësit është shprehur qartë që formoj një faktor rëndues kur shumata e caktuar e parave tejkalohe sikur përmendët në paragrafin 2 të Neni 339 të KPK-së si **rezultat** i kryerjes së veprës penale në kundërshtim me paragrafin 1 të Neni 339 të KPK-së.

Kjo është e krahasueshme me përshkrimin e dhënë në par. 4 Neni 154 të KPK-së, ku ligjbërësi përshkruan rrethanën rënduese të vdekjes së viktimës në rast se ndonjëri shkakton lëndim trupor, vetëm me qëllim që të shkaktoj dëm trupor, por vdekja është si **rezultat** i sulmit të qëllimshëm.

¹ Shifrat janë marrë nga Aktvendimi i kolegjit prej tre gjyqtarësh të Gjykatës së Qarkut në Pejë, KP nr. 5/10 të datës 22.01.2010.



Nuk ka qellim lidhur me *rezultat*in e kërkuar, jo në Nenin 154 par. 4 të KPK-së lidhur me vdekjen dhe gjithashtu jo në Nenin 339 par. 2 të KPK-së lidhur me shumën e më shumë se 2.500€.

Si rrjedhojë korniza ligjore e dënimit parasheh deri në tre vite burgim.

c) Lidhur me çështjen të veprës penale të *Mashtrimit*, Neni 261 par 1 të KPK-së, kolegji i referohet klasifikimit ligjor dhe përfshin ligjin me rezultatit e njëjtë sikur që ka bërë gjykata e shkallës së parë:

Duke zbatuar parimin e përgjithshëm se vepra më e rëndë penale e përvetëson atë më të lehtë, ligji cakton veprën penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare apo Autorizimit, e dënueshme deri në 8 vite burgim në rastet renduese krahasuar me *Mashtrimin*, i dënueshëm deri në 5 vite burgim, si një vepër më e rëndë penale.

Përveç kësaj, kolegji gjithashtu ndan mendimin e gjykatës së shkallës së parë se vepra penale ishte e kryer në ditën kur i pandehuri kishte kërkuar para (10.000,00€) dhe kishte pranuar 3.000€, dhe në muajt në vijim, paratë e pranuar në rastin e dytë dhe të tretë, ishte vetëm përmbushja e premtimit të dhënë në ditën kur ishin kërkuar paratë nga i pandehuri.

Prandaj- për dallim nga mendimi i Prokurorit Publik- dënimi i kërkuar për veprën penale për *Mashtrim* është përjashtuar dhe ankesa e Prokurorit Publik në këtë drejtim është dashur që të refuzohet si e pabazuar.

d) Përcaktimi i Dënimit

Në pajtim me gjykatën e shkallës së parë, kolegjit gjykuar i duket e pavend që të caktoj dënimin prej gjysme të maksimumit të paraparë me ligj. Në të mirën e të pandehurit duhet të merret parasysh se nuk kishte dënime të mëparshme dhe se nuk kishte ankesa kundër të pandehurit apo zbatimit të detyrave të tij zyrtare. Si një faktor lehtësues, kolegji gjithashtu ka marr parasysh se i pandehuri ndërkohë i ka kthyer paratë që i kishte marr në kundërshtim me ligjin.

Në dis-avantazhin e tij, trupi gjykuar ka vlerësuar faktin se i pandehuri saktësisht ka planifikuar veprën e tij penale duke zgjedhur palën e dëmtuar si një person i cili veç me kishte vuajtur nga humbja e njërit nga të afërmit e tyre, duke shfrytëzuar situatën e tyre të ndjerë dhe duke vepruar në tre raste, gjë e cila përjashton opsionin se ai ka dështuar nga “shfrytëzimi i një shanse të rastit”.

Përveç kësaj, shumën e lartë e pranimit të paligjshëm të hollave ka rritur shkallën në dëm të pandehurit, për arsye se vlera totale gati ka arit shumën prej 5.000 Euro dhe si rrjedhojë pothuajse kushti rendues nga Neni 339 par 3 të KPK-së është plotësuar, pasi që paragrafi i kësaj dispozite hap kornizën e dënimit deri në 8 vite heqje lirie kur vepra penale në kundërshtim me Nenin 339 par. 1 të KPK-së rezulton në një përfim material që tejkalon shumën 5.500 euro.

Duke vlerësuar të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues, kolegji është i bindur se një dënim prej një vit dhe gjashtë muaj burgim është i nevojshëm dhe i përshtatshëm në njërin anë dhe nuk duhet të tejkalohet në anën tjetër me qellim që të arrij qëllimin e dënimit sikur parashihet nga Neni 34 i KPK-së.



Dënimi Alternativ

Për dallim nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë, kolegji është i bindur se dënimi me kusht siç parashihet nga Neni 41 deri në 44 të KPK-së, është i pamjaftueshëm dhe jo i duhur që të arrij qëllimin e dënimit, në veçanti në lidhje me Nenin 34 par. 2 të KPK-së.

Një dënim i thjeshtë me kusht në këtë rast të veçantë do të keqkuptohej pashmangshmërisht nga shtresa të caktuara të popullsisë siç janë policët dhe autoritetet tjera në Kosovë, se një vepër penale në saje të Nenit 339 të KPK-së të duket si një vepër penale më pak serioze.

Kolegji gjykues përcjell argumentimin e Prokurorit Publik se vetëm një dënim jo me kusht është në gjendje të parandaloj kryesit tjerë të mundshëm nga kryerja e veprave penale të tilla dhe si rrjedhojë kolegji ka miratuar ankesën e Prokurorit Publik lidhur me këtë çështje.

Prandaj, është vendosur sikur në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E QARKUT NË PEJË, AP.nr.93/10 Datë 07 Shtator 2010.

Anëtarët e Kolegjit Gjykues

Riku JAAKKOLA

Salih MEKAJ



Kryetari i Trupit Gjykues

Ingo RISCH

Përkthyesi: E.Zenunaj-Eulex1106L